REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT

PROJEKT – VENDIM

Nr. 47 . **Date** 21 / 05 /**2026**

"PËR DHENIEN DHENIEN ME QIRA TË SIPËRFAQES 50 HA NË NGASTRËN ME KOD KADASTRAL KO02 00 019 NË EKONOMINË KULLOSORE "BILISHT"
(Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme)

Ne zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" (I ndryshuar), neni 8 pika 2, Neni 9 pika 1, nenpikat 1.1 shkronja "b" dhe 1.2 shkronjat "a" dhe "c", nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronja "e/1", nenit 55 pikat 3 , nenit 64 shkronja "a" dhe "c".Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqiperisë" (i ndryshuar), Ligjit nr. 57/2020 "Per Pyjet", Nenit 15,17 te Ligjit 9693 date 19.03.2007 "Per fondin kullosor" (i ndryshuar), VKM Nr. 398 date 13.05.2020 "Per disa Ndryshime ne VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 " Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të Ish-Komunave/ Bashkive".VKM Nr.559, date 29.07.2022 "Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore, shtojca nr. 1 "Per tarifat e dhenies ne perdorim e fondit pyjor kombetar per veprimtarite e ushtruara ne kete fond" Lidhja Nr. 3. VKM Nr.267 date 27.04.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne VKM Nr. 559, date 29.07.2022 . Udhëzimi I Ministrit të Mjedisit Nr. 01 datë 09.06.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe në Raportin Tekniko- Ekonomik Nr.1875/1 Prot date 21 .05 .2026.

PROPOZOJ:

1. Dhenien e miratimit per dhenien me qira te siperfaqes prej 50 ha ne ngastrën me nr. 19 me kod kadastral KO 02 00 019,pjese e ekonomise kullosore Bilisht.
2. Afati i dhënies për përdorim do të jetë 10 vjet.
3. Bashkengjitur Raporti Tekniko- Ekonomik Nr.1875/1 Prot,datë 21 /05/2026 i Sektorit të Menaxhimit te Pyjeve dhe Mjedisit.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkise Devoll dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit per zbatimin e ketij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në nenin 55 pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar

Konceptoi:Drejtor i Drejtorise te Pyjeve dhe Mjedisit
Edmir Cenolli
Konfirmoi bazen ligjore: Prgj.Sektorit Juridik
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISE
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DEVOLL

Adresa: Lagjia Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com;
web:http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TE PYJEVE,KULLOTAVE DHE MJEDISIT

Nr.1875 Prot

Bilisht, më 21.05.2026

RELACION

Për dhënien në përdorim me kontratë qeraje të një sipërfaqeje prej 50 ha , për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme

I. QËLLIMI

Ky relacion hartohet për dhënin e miratimit e kërkesës të subjektit privat Merja& Co Shpk me nipt:M51719042S , për marrjen me qera të një sipërfaqeje në administrim të Bashkisë, me qëllim zhvillimin e aktivitetit për kultivimin e bimëve të ndryshme dhe mbarështimin e florës së egër.

Ky aktivitet synon përdorimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqes, zhvillimin e bimëve dekorative, aromatike apo medicinale, si dhe krijimin e një mjedisi më të gjelbër dhe të sistemuar.

II. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti do të ushtrojë aktivitet në:

- mbjelljen dhe kultivimin e bimëve të ndryshme;
- kultivimin e bimëve aromatike, medicinale dhe dekorative;
- mirëmbajtjen e sipërfaqes së marrë në përdorim;
- ruajtjen dhe zhvillimin e florës së zonës.

Aktiviteti do të zhvillohet duke respektuar kushtet e përcaktuara nga Bashkia dhe rregullat për mbrojtjen e siperfaqeve Pyjore/Kullosore .

III. PËRPARËSITË

- Mirëmbajtje dhe sistemim i territorit.
- Krijim i mundësive të reja për punësim.
- Përmirësim i mjedisit dhe gjelbërimit të zonës.
- Përdorim më efektiv i sipërfaqeve të lira.
- Të ardhura për Bashkinë nga kontrata e qerasë.

IV. MANGËSITË

- Rrezik i mosrespektimit të kushteve të kontratës.
- Mundësi dëmtimi të mjedisit në rast përdorimi të pakontrolluar.
- Nevojë për monitorim të vazhdueshëm nga Bashkia.
- Mundësi mosrealizimi të investimeve të parashikuara.

V. KONKLUZION

Dhënia me kontratë qeraje e sipërfaqes për këtë aktivitet ka me teper vlera positive si ne terren dhe ne anen ekonomike , pasi ndikon në mirëmbajtjen e territorit, zhvillimin e zonës dhe krijimin e vlerave mjedisore e ekonomike, duke sjellë njëkohësisht të ardhura për Bashkinë. Aktiviteti do të zhvillohet në përputhje me kushtet e përcaktuara dhe nën mbikëqyrjen e strukturës përgjegjëse për Pyjet dhe Mjedisin ..

Konceptoi:

Prgj.Sek. Menaxhimi Pyjesh dhe Mjedisi

Orgest Cenolli

Pranoi:

Drejtori i Drejtorise

Edmir Cenolli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE,KULLOTAVE DHE MJEDISIT

Nr. 1875/1 **Prot** **Bilisht më** 21/05/**2026**

RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË DEVOLL

Për dhënien në përdorim me kontrate qeraje
Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme

Bazuar në Urdhërin **Nr.154 ,07.05.2026** të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore objekt i dhënies në përdorim, grupi i punës i përbërë nga Specialist /Ixhinier i Pyjeve , Kullotave dhe Mjedisit : Orgest Cenolli , Antonio Kapshtica dhe Denis Xhuri : nga data 07.05.2026 deri në datën 11.05.2026 studioi kërkesën e subjektit Merja& Co Shpk me nipt:M51719042S , realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore objekt i dhënies në përdorim. Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor / kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar në total është 50 ha , dhe shtrihet ne ngastrën , 019 me sip (142.44), pjesë e Ekonomisë Kullosore " Bilisht" me kod kadastral KO 02 00 019 , ne pronësi / administrim të Bashkisë Devoll.
Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohet në aneksin 1 të këtij raporti . Nga verifikimi në terren rezulton se nuk ka ndryshime në terren te ngastrës .
Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Shoqëria Merja& Co Shpk Shpk nuk ndyshojnë kategorinë e përdorimit të tokës por jepen në përdorim me kontratë qiraje me afat 10 vjecar .Për këtë arsye do të vëmë në zbatim V.K.M Nr . 559 , date 29.07.2022 .

Proçedura që ndiqen për dhënien në përdorimne Vendim Nr . 559 , date 29.07.2022 " Për përcaktimi e cmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar , për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jodrusore pyjore"
Shtojca Nr 1 "Për tarifat e dhenies ne përdorim e fondit pyjor kombetar për veprimtarite e ushtruara ne kete fond" . ***Lidhja Nr 3***

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër , shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur , vetëm pas lidhjes së kontratës me **Bashkinë Devoll** dhe likujdimin të tarifës **TOTAL : 670,320 lek/vit .**

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në, Vendimin Nr . 559 , date 29.07.2022 " Për përcaktimi e cmimeve dhe tarifave për dhenin ne shfrytëzim përdorim te fondit pyjor kombëtar , për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jodrusore pyjore". **Shtojca Nr 1** "Për tarifat e dhenies ne përdorim e fondit pyjor kombetar për veprimtarite e ushtruara ne kete fond" .***Lidhja Nr 3***

a) Vlerën e përdorimit e sipërfaqes lek/ha/vit 660,000 lekë

Trungishte _____ha x_____ lek = _____ lekë.
Cungishte ha x lek = lekë.
Shkure _____ha x _____lek = _____ lekë.
Kullotë ha x lek = _____lekë
Tokë me bimësi pyjore/djerr/inproduktive_50 ha x 13 200 leke = 660,000 lekë
Inproduktive etj __ha x_____ lek = _____lekë.

b) Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km/vit 10,320 lekë

Trungishte km x lekë = lekë.
Cungishte km x lekë = lekë
Shkure km x lekë = lekë
Kullotë km x lekë = lekë
Tokë me bimësi pyjore/djerr/inproduktive 0.344 km x 30,000 = 10,320 lekë
Inproduktive etj km x lekë = lekë.

c). Vlera e prodhimeve të dyta pyjore _____-_____ lekë.

4. Kullotja krere te imta x lek/koke = lekë.
5. Vlera e faunës _____-_____lekë.
6. Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zvëndësime, përmirësime, etj _-_ lekë.
7. Të tjera _____-_____ lekë.

PËRPILUSIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Specialist Ixhinier Pyjesh dhe Mjedisi

Orgest Cenolli

Antonio Kapshtica


Denis Xhuri

Drejtori Drejtorisë së Pyjeve
dhe Mjedisit
Edmir Cenolli

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

Adresa: Lagjia. Nr 1 Rr. 24 Tetori Nr. 5, Tel&Fax +35581122288 E-mail bashkiadevoll@gov.al
web:http://bashkiadevoll.gov.al


009
015
016
017
008
018
150
KORCË
019
007
023
020
022
021
151
024
025
0 250 500 m
N
W
E
S
LEGJENDE
QENDER BANIMI
Aux_data
Rendi_3_Kufi_bashki_VKM360
regions
Interim databse
identification_data
Shtet (tmp)
forest_situation
pasture_situation
BaseLayers
Mbareshtim Flores te Eger dhe bimeve te ndryshme
Google Earth

GJATESIA E PERDORIMIT TE RRUGES







